BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017, Prishtinë), dhe në bazë të nenit 98 dhe 135 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2024 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR STANDARDET TEKNIKE PËR AUTENTIFIKIM TË THELLUAR TË KLIENTIT DHE STANDARDET E HAPURA, TË PËRBASHKËTA DHE TË SIGURTA TË KOMUNIKIMIT

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kërkesave që duhet t'i respektojnë ofruesit e shërbimeve të pagesave me qëllim të zbatimit të masave të sigurisë që u mundësojnë atyre:
   1.1. zbatimin e procedurës së autentifikimit të thelluar të klientit në përputhje me nenin 97 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave;
   1.2. përjashtimin nga zbatimi i kërkesave të sigurisë për autentifikimin e thelluar të klientit nëse përmbushen kushtet e specifikuara dhe të kufizuara bazuar në nivelin e rrezikut, shumën dhe përsëritjen e transaksionit të pagesës dhe të kanalit të pagesës që përdoret për ekzekutimin e tij;
   1.3. mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të personalizuara të sigurisë të PSHP-ve;
   1.4. vendosjen e standardeve të përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave të llogarisë, ofruesve të shërbimeve të inicimit të pagesave, ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë, kryerësve të pagesës, marrësve të pagesës dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave në lidhje me ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të pagesave në zbatim të Pjesa IV të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
2. Kjo Rregullore zbatohet për ofruesit e shërbimeve të pagesave, siç përcaktohet në nenin 1, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 2
Përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave.
2. Përveç paragrafit 1, për qëllime të zbatimit të kësaj Rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë kuptimin e mëposhtëm:
   2.1. "OSHPLL" nënkupton Ofruesin e Shërbimeve të Pagesave të Llogarisë;
   2.2. "SHILL" nënkupton Shërbimet e Informacionit të Llogarisë;
   2.3. "OSHILL" nënkupton Ofruesin e Shërbimeve të Informacionit të Llogarisë;
   2.4. "BQK" nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
   2.5. "EBA" nënkupton Autoritetin Bankar Evropian;
   2.6. "VPP" nënkupton Vlerën e Pragut të Përjashtimit;
   2.7. "Ligji për Shërbimet e Pagesave" nënkupton Ligjin Nr. 08/L-328 për Shërbimet e Pagesave;
   2.8. "SHIP" nënkupton Shërbimet e Inicimit të Pagesave;
   2.9. "OSHIP" nënkupton Ofruesin e Shërbimeve të Inicimit të Pagesave;
   2.10. "OSHP" nënkupton Ofruesin e Shërbimeve të Pagesave;
   2.11. "PSHP" nënkupton Përdoruesin e Shërbimeve të Pagesave.

Neni 3
Kërkesat e përgjithshme për autentifikimin

1. OSHP-të kanë mekanizma funksionale të monitorimit të transaksioneve që u mundësojnë zbulimin e transaksioneve të pagesave të paautorizuara ose mashtruese me qëllim të zbatimit të masave të sigurisë të përcaktuara në nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 1.
   1.1. këta mekanizma bazohen në analizën e transaksioneve të pagesave duke marrë parasysh elementet që janë tipike për PSHP në rrethanat e përdorimit normal të kredencialeve të personalizuara të sigurisë.
2. OSHP-të sigurojnë që mekanizmat e monitorimit të transaksioneve të marrin parasysh, të paktën, secilin nga faktorët e mëposhtëm të bazuar në rrezik:
   2.1. listat e elementeve të autentifikimit, të komprometuara ose të vjedhura;
   2.2. shumën e secilit transaksion pagese;
   2.3. skenarët e njohur të mashtrimit në ofrimin e shërbimeve të pagesave;
   2.4. shenjat e infektimit nga programe keqdashëse (*signs of malware infection*) në çdo sesion të procedurës së autentifikimit;
   2.5. në rast se pajisja e qasjes ose softueri ofrohet nga OSHP-ja, regjistrin e përdorimit të pajisjes për qasje ose softuerit të ofruar në PSHP-ja dhe përdorimit jonormal të pajisjes për qasje ose softuerit.

Neni 4
Rishikimi i masave të sigurisë

1. Zbatimi i masave të sigurisë të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Rregullore, dokumentohet, testohet, vlerësohet dhe auditohet periodikisht në përputhje me kornizën ligjore në fuqi për OSHP-të nga auditorë me ekspertizë në sigurinë e TIK-ut (teknologji informative dhe komunikimi) dhe pagesave dhe të pavarur nga pikëpamja operacionale brenda ose nga OSHP-ja.
2. Periudha ndërmjet auditimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet duke marrë parasysh kornizën përkatëse të kontabilitetit dhe auditimit ligjor të zbatueshme për OSHP-në si në vijim:
   2.1. OSHP-të që përdorin përjashtimin e përcaktuar në nenin 18 të kësaj rregullore i nënshtrohen auditimit të metodologjisë, modelit dhe normave të raportuara të mashtrimit të paktën në baza vjetore. Auditori që kryen këtë auditim ka ekspertizë në sigurinë e TIK-ut dhe pagesave dhe është i pavarur në aspektin operacional brenda ose nga OSHP-ja. Gjatë vitit të parë të zbatimit të përjashtimit sipas nenit 18 të kësaj rregullore dhe të paktën çdo 3 vjet më pas, ose më shpesh me kërkesë të BQK-së, ky auditim kryhet nga një auditor i jashtëm i pavarur dhe i kualifikuar.
3. Ky auditim paraqet vlerësimin dhe raportin mbi përputhshmërinë e masave të sigurisë të PSHP-së me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore. Raporti i vihet në dispozicion BQK-së sipas kërkesës.

KAPITULLI II
MASAT E SIGURISË PËR ZBATIMIN E AUTENTIKIMIT TË THELLUAR TË KLIENTIT

Neni 5
Kodi i autentifikimit

1. Kur OSHP-të zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit në përputhje me nenin 97 paragrafin 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, autentifikimi bazohet në dy ose më shumë elemente të cilat kategorizohen si njohuri, posedim dhe qenësi dhe rezulton në gjenerimin e kodit të autentifikimit:
   1.1. kodi i autentifikimit pranohet vetëm një herë nga OSHP-ja kur kryerësi i pagesës përdor kodin e autentifkimit për të hyrë në llogarinë e tij të pagesës në internet, për të iniciuar një transaksion elektronik pagese ose për të kryer ndonjë veprim përmes një kanali nga distanca që mund të nënkuptojë rrezik për mashtrim me pagesë ose abuzime të tjera.
2. Për qëllim të paragrafit 1 te këtij neni, OSHP-të miratojnë masa sigurie duke siguruar që secila nga kërkesat e mëposhtme plotësohet:
   2.1. asnjë informacion për asnjë nga elementet e përcaktuara në paragrafin 1 nuk mund të nxirret nga shpalosja e kodit të autentifikimit;
   2.2. gjenerimi i kodit të ri të autentifikimit nuk është i mundur bazuar në njohuritë për ndonjë kod tjetër autentifikimi të gjeneruar më parë;
   2.3. kodi i autentifikimit nuk mund të falsifikohet.

3. OSHP-të sigurojnë që autentifikimi me anë të gjenerimit të kodit të autentifikimit përfshin secilën nga masat e mëposhtme:

   3.1. kur autentifikimi për qasje nga distanca, pagesa elektronike nga distanca dhe çdo veprim tjetër përmes një kanali në distancë që mund të nënkuptojë rrezikun e mashtrimit me pagesa ose abuzime të tjera ka dështuar të krijojë një kod autentifikimi për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, nuk është e mundur të identifikohet cili nga elementet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, ishte i pasaktë;

   3.2. numri i përpjekjeve të dështuara të autentifikimit që mund të ndodhin në mënyrë të njëpasnjëshme, pas së cilës veprimet e referuara në nenin 97, paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave bllokohet përkohësisht ose përgjithmonë, nuk shkon përtej pesë përpjekjeve brenda një periudhe të caktuar kohore;

   3.3. sesionet e komunikimit mbrohen nga kapja e të dhënave të autentifikimit të transmetuara gjatë autentifikimit dhe nga manipulimi nga palët e paautorizuara në përputhje me kërkesat në Kapitullin V të kësaj rregullore;

   3.4. koha maksimale pa aktivitet nga kryerësi i pagesës pasi është autentifikuar për qasjen në llogarinë e tij të pagesave në internet nuk duhet të kalojë 5 (pesë) minuta.

4. Kur bllokimi i përcaktuar në nënparagrafin 3.2 në këtë nen është i përkohshëm, kohëzgjatja e atij bllokimi dhe numri i tentativave përcaktohen bazuar në karakteristikat e shërbimit që i ofrohet kryerësit të pagesës dhe të gjitha rreziqet përkatëse të përfshira, duke marrë parasysh, të paktën, faktorët e përcaktuar në nenin 3 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje:

   4.1. paguesi lajmërohet përpara se bllokimi të bëhet i përhershëm;

   4.2. kur bllokimi është bërë i përhershëm, vendoset një procedurë e sigurt që i lejon paguesit të rifitojë përdorimin e instrumenteve të bllokuara të pagesave elektronike.

Neni 6
Lidhjet dinamike

1. Kur OSHP-të aplikojnë autentifikim të thelluar të klientit në përputhje me nenin 97, paragrafi 2 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, përveç kërkesave të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ata miratojnë gjithashtu masa sigurie që plotësojnë secilën nga kërkesat e mëposhtme:

   1.1. paguesi vihet në dijeni për shumën e transaksionit të pagesës dhe për përfituesin;

   1.2. kodi i gjeneruar i autentifikimit është specifik për shumën e transaksionit të pagesës dhe për të përfituesin , për të cilin paguesi ka rënë dakord në momentin e inicimit të transaksionit;

   1.3. kodi i autentifikimit i pranuar nga OSHP-ja korrespondon me shumën specifike origjinale të transaksionit të pagesës dhe me identitetin e marrësit të pagesës për të cilin është rënë dakord nga paguesi;

   1.4. çdo ndryshim në shumën ose marrësin e pagesës rezulton në pavlefshmërinë e kodit të gjeneruar të autentifikimit.

2. Për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni, OSHP-të miratojnë masa sigurie të cilat sigurojnë konfidencialitetin, autentictetin dhe integritetin e secilës prej sa vijon:

   2.1. shumën e transaksionit dhe marrësin e pagesave gjatë të gjitha fazave të autentifikimit;

2.2. informatat e shfaqur te kryerësi i pagesës gjatë të gjitha fazave të autentifikimit, duke përfshirë gjenerimin, transmetimin dhe përdorimin e kodit të autentifikimit.

3. Për qëllimet e nënparagrafit 1.2 të këtij neni dhe ku OSHP-të aplikojnë autentifikim të thelluar të klientit në përputhje me nenin 97, paragrafi 2 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, për kodin e autentifikimit zbatohen kërkesat e mëposhtme:

3.1. për një transaksion pagese nëpërmjet kartelës, për të cilin paguesi ka dhënë pëlqimin për shumën e saktë të fondeve që do të bllokohen në përputhje me nenin 75, paragrafi 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, kodi i autentifikimit është specifik për shumën që paguesi ka dhënë pëlqimin për t'u bllokuar dhe që është rënë dakord nga paguesi gjatë inicimit të transaksionit;

3.2. në lidhje me transaksionet e pagesave për të cilat paguesi ka dhënë pëlqimin për të ekzekutuar një grup transaksionesh pagese elektronike në distancë për një ose disa përfitues, kodi i autentifikimit është specifik për shumën totale të grupit të transaksioneve të pagesës dhe për marrësit e specifikuar të pagesës.

Neni 7
Kërkesat e elementeve të kategorizuara si njohuri

1. OSHP-të miratojnë masa për të zbutur rrezikun që elementët e autentifikimit të thelluar të klientit të kategorizuar si njohuri të zbulohen nga palët e paautorizuara ose t'u zbulohen atyre.

2. Përdorimi i këtyre elementeve nga paguesi i nënshtrohet masave zbutëse për të parandaluar shpalosjen e tyre te palët e paautorizuara.

Neni 8
Kërkesat e elementeve të kategorizuara si posedim

1. OSHP-të miratojnë masa për të zbutur rrezikun që elementët e autentifikimit të thelluar të klientit të kategorizuar si posedim të përdoren nga palë të paautorizuara.

2. Përdorimi nga paguesi i këtyre elementeve i nënshtrohet masave të krijuara për të parandaluar përsëritjen e elementeve.

Neni 9
Kërkesat për pajisjet dhe softuerin, të lidhur me elemente të kategorizuara si të qenësishme

1. OSHP-të miratojnë masa për të zbutur rrezikun që elementët e autentifikimit të kategorizuar si të qenësishëm dhe të lexuar nga pajisjet e qasjes dhe softueri, që i ofrohen paguesit, të shpalosen nga palë të paautorizuara. OSHP-të sigurojnë të paktën që këto pajisje të qasjes dhe softuer të kenë një probabilitet shumë të ulët që një palë e paautorizuar të autentifikohet si kryerës i pagesës.

2. Përdorimi nga kryerësi i pagesës i këtyre elementeve i nënshtrohet masave që sigurojnë që këto pajisje dhe softuer garantojnë rezistencë ndaj përdorimit të paautorizuar të elementeve nëpërmjet qasjes në pajisje dhe softuer.

Neni 10
Pavarësia e elementeve

1. OSHP-të sigurojnë që përdorimi i elementeve të autentifikimit të thelluar të klientit të përcaktuar në nenet 7, 8 dhe 9 të kësaj rregullore i nënshtrohet masave që sigurojnë që, për sa i përket teknologjisë, algoritmeve dhe parametrave, shkelja e njërit prej elementeve të mos rrezikojë besueshmërinë e elementeve të tjerë.
2. OSHP-të miratojnë masa sigurie, kur ndonjë nga elementët e autentifikimit të thelluar të klientit ose vetë kodi i autentifikimit përdoret nëpërmjet një pajisjeje me shumë qëllime, për të zbutur rrezikun që do të rezultonte nga kompromet imi i kësaj pajisjeje shumëfunksionale.
3. Për qëllimet e paragrafit 2 të këtij neni, masat lehtësuese përfshijnë secilën nga sa vijon:
   3.1. përdorimin e mjediseve të ndara të sigurta të ekzekutimit përmes softuerit të instaluar brenda pajisjes shumëfunksionale;
   3.2. mekanizmat për të siguruar që softueri ose pajisja nuk është ndryshuar nga paguesi ose nga një palë e tretë;
   3.3. ku janë bërë ndryshime, mekanizmat për t'i zbutur pasojat e tyre.

KAPITULLI III
PËRJASHTIMET NGA AUTENTIFIKIMI I THELLUAR I KLIENTIT

Neni 11
Qasje në informacionin e llogarisë së pagesës drejtpërdrejt me ofruesin e shërbimit të pagesave të shërbimit të llogarisë ose nëpërmjet një ofruesi të shërbimit të informacionit të llogarisë

1. OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit, nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregullore, kur një PSHP hyn drejtpërdrejt në llogarinë e tij të pagesave në internet, me kusht që qasja të kufizohet në një nga artikujt e mëposhtëm në internet pa shpalosjen e të dhënave të ndjeshme të pagesës:
   1.1. gjendjen e një ose më shumë llogarive të caktuara të pagesave;
   1.2. transaksionet e pagesave të kryera në 90 ditët e fundit nëpërmjet një ose më shumë llogarive të caktuara të pagesave.
2. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, OSHP-të nuk përjashtohen nga zbatimi i autentifikimit të thelluar të klientit kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:
   2.1. PSHP-ja ka qasje online në informacionin e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni për herë të parë;
   2.2. kanë kaluar më shumë se 180 ditë që nga hera e fundit që PSHP-ja ka qasje në internet në informacionin e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe është zbatuar autentifikimi i thelluar i klientit.
3. OSHP-të nuk zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit kur PSHP-ja ka qasje në llogarinë e tij të pagesave në internet nëpërmjet një OSHILL, me kusht që qasja të kufizohet në një nga elementët e mëposhtëm në internet pa shpalosjen e të dhënave të ndjeshme të pagesave:

3.1. gjendjen e një ose më shumë llogarive të caktuara të pagesave;

3.2. transaksionet e pagesave të kryera në 90 ditët e fundit nëpërmjet një ose më shumë llogarive të caktuara të pagesave.

4. Me përjashtim të paragrafit 3, OSHP-të zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

4.1. PSHP-ja ka qasje online në informacionin e specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni për herë të parë nëpërmjet OSHILL-së;

4.2. kanë kaluar më shumë se 180 ditë që nga hera e fundit që PSHP-ja ka qasur në internet informacionin e specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni nëpërmjet OSHILL dhe u zbatua autentifikimi i thelluar i klientit.

5. Me përjashtim të paragrafit 3 të këtij neni, OSHP-të lejohen të zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit kur PSHP-ja ka qasje në llogarinë e saj të pagesave në internet nëpërmjet OSHILL-së dhe OSHP-ja ka arsye të justifikuara objektivisht dhe të evidentuara siç duhet në lidhje me qasjen e paautorizuar ose mashtruese në llogarinë e pagesës. Në një rast të tillë, OSHP-ja dokumenton dhe arsyeton në mënyrë të duhur në BQK, sipas kërkesës, arsyet për zbatimin e autentifikimit të thelluar të klientit.

6. OSHPSHLL-ve që ofrojnë një ndërlidhje të dedikuar siç përcaktohet në nenin 32 të kësaj rregullore nuk u kërkohet të zbatojnë përjashtimin e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni për qëllimin e mekanizmit të kontingjentit të përcaktuar në nenin 34 paragrafi 4 të kësaj rregullore, në rastet kur nuk zbatojnë përjashtimin e përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni në ndërlidhjen direkte që përdoret për autentifikimin dhe komunikimin me PSHP-të e tyre.

Neni 12
Pagesa pa kontakt në pikën e shitjes

1. OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit nëse i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 2 të kësaj rregullore , kur paguesi inicion një transaksion pagese elektronike pa kontakt, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

1.1. shuma individuale e transaksionit të pagesës elektronike pa kontakt nuk i kalon 50 euro; dhe

1.2. shuma kumulative e transaksioneve të mëparshme të pagesave elektronike pa kontakt të iniciuara me anë të një instrumenti pagese me funksion pa kontakt nga data e aplikimit të fundit të autentifikimit të thelluar të klientit nuk kalon 150 euro; ose

1.3. numri i transaksioneve të njëpasnjëshme të pagesave elektronike pa kontakt të iniciuara nëpërmjet instrumentit të pagesës që ofron një funksionalitet pa kontakt që nga zbatimi i fundit i autentifikimit të thelluar të klientit nuk është më i madh se pesë transaksione.

Neni 13
Terminalet e pambikëqyrura për tarifat e transportit dhe tarifat e parkimit

OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit nëse plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregullore, kur paguesi inicion një transaksion pagese elektronike në

një terminal pagese të pambikëqyrur për qëllimin e pagesës së një tarife transporti ose një tarife parkimi.

Neni 14
Përfituesit e besuar

1. OSHP-të zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit kur një pagues krijon ose ndryshon një listë të përfituesve të besuar përmes OSHPLL-së së paguesit.
2. OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit nëse plotësohen kërkesat e përgjithshme të autentifkimit, kur paguesi inicion një transaksion pagese dhe marrësi i pagesës përfshihet në një listë të përfituesve të besuar të krijuar më parë nga paguesi.

Neni 15
Transaksionet e përsëritura

1. OSHP-të zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit kur një pagues krijon, ndryshon ose inicion për herë të parë një seri transaksionesh të përsëritura me të njëjtën shumë dhe me të njëjtin përfitues.
2. OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit nëse i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të autentifikimit për inicimin e të gjitha transaksioneve të mëpasshme të pagesave të përfshira në serinë e transaksioneve të pagesave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 16
Transfertat e kredisë ndërmjet llogarive të mbajtura nga i njëjti person fizik ose juridik

OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit nëse i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregullore, kur paguesi fillon një transferim kredie në rrethana kur paguesi dhe marrësi janë i njëjti person fizik ose juridik dhe të dyja llogaritë e pagesave mbahen nga i njëjti OSHPLL.

Neni 17
Transaksionet me vlerë të ulët

1. OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit, kur paguesi inicion një transaksion pagese elektronike në distancë, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
   1.1. shuma e transaksionit të pagesës elektronike në distancë nuk kalon 30 euro; dhe
   1.2. shuma kumulative e transaksioneve të mëparshme të pagesave elektronike në distancë të iniciuara nga paguesi që nga aplikimi i fundit i autentifikimit të thelluar të klientit nuk i kalon 100 euro; ose
   1.3. numri i transaksioneve të mëparshme të pagesave elektronike në distancë të iniciuara nga paguesi që nga zbatimi i fundit i autentifikimit të thelluar të klientit nuk i kalon pesë transaksione të njëpasnjëshme individuale të pagesave elektronike në distancë.

Neni 18
Proceset dhe protokollet e sigurta të pagesave të korporatave

OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit, në lidhje me personat juridikë që iniciojnë transaksione të pagesave elektronike përmes përdorimit të proceseve apo protokolleve të dedikuara të pagesave që u vihen në dispozicion vetëm paguesve që nuk janë klientë, kur BQK-ja vlerëson që këto procese ose protokolle garantojnë të paktën nivele ekuivalente sigurie me ato të parashikuara nga Ligji për Shërbimet e Pagesave.

Neni 19
Analiza e rrezikut të transaksionit

1. OSHP-të mund të mos zbatojnë autentifikim të thelluar të klientit kur paguesi inicion transaksion të pagesave elektronike në distancë të identifikuar nga OSHP-ja si transaksion me nivel të ulët rreziku sipas mekanizmave të monitorimit të transaksioneve të parashikuara në nenin 3 dhe në nënparagrafin 2.3 të këtij neni.
2. Transaksioni i pagesës elektronike i përcaktuar në paragrafin 1 konsiderohet se paraqet nivel të ulët rreziku kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
   2.1. norma e mashtrimit për atë lloj transaksioni, e raportuar nga OSHP-ja dhe e llogaritur në përputhje me nenin 20 të kësaj rregullore, është ekuivalente ose më e ulët se normat referencë të mashtrimit të specifikuara në tabelën e vendosur në shtojcën 1 të kësaj rregullore për "pagesat elektronike me kartelë në distancë" dhe "transferimet elektronike të kredisë në distancë," përkatësisht;
   2.2. shuma e transaksionit nuk e kalon VPP-në përkatëse të specifikuar në tabelën e paraqitur në shtojcën 1 të kësaj rregullore;
   2.3. OSHP-të, si rezultat i kryerjes së një analize të rrezikut në kohë reale, nuk kanë identifikuar asnjë nga elementet e mëposhtme:
      2.3.1. shpenzime jonormale ose model të sjelljes së paguesit;
      2.3.2. informacion të pazakontë në lidhje me pajisjen e qasjes/softuerin e paguesit;
      2.3.3. infektim me program keqdashës (malware) në çdo sesion të procedurës së autentifikimit;
      2.3.4. skenar të njohur mashtrimi në ofrimin e shërbimeve të pagesave;
      2.3.5. vendndodhje jonormale të paguesit;
      2.3.6. vendndodhje me rrezik të lartë të marrësit të pagesës.
3. OSHP-të që synojnë të përjashtojnë transaksionet e pagesave elektronike në distancë nga autentifikimi i thelluar i klientit me arsyetimin se ato paraqesin rrezik të ulët, marrin parasysh të paktën faktorët e mëposhtëm të bazuar në rrezik:
   3.1. modelet e mëparshme të shpenzimeve të PSHP-së individual;
   3.2. historikun e transaksioneve të pagesave të secilit prej PSHP-ve të OSHP-së;

3.3. vendndodhjen e paguesit dhe të marrësit të pagesës në momentin e transaksionit të pagesës në rastet kur pajisja e qasjes ose softueri sigurohet nga OSHP-ja;

3.4. identifikimin e modeleve jonormale të pagesave të PSHP-së në lidhje me historinë e transaksioneve të pagesave të përdoruesit.

4. Vlerësimi i bërë nga OSHP-ja sipas paragrafit të mëparshëm kombinon të gjithë këta faktorë të bazuar në rrezik në një vlerësim rreziku për çdo transaksion individual për të përcaktuar nëse një pagesë specifike duhet të lejohet pa autentifikim të thelluar të klientit.

Neni 20
Llogaritja e normave të mashtrimit

1. Për çdo lloj transaksioni të përcaktuar në tabelën e Shtojcës 1 te kësaj rregullore, OSHP-ja siguron që normat e përgjithshme të mashtrimit që mbulojnë si transaksionet e pagesave të autentifikuara nëpërmjet autentifikimit të thelluar të klientit ashtu edhe ato të ekzekutuara sipas ndonjë prej përjashtimeve të përcaktuar në nenet 14 deri në 19 të kësaj rregullore janë ekuivalente ose më e ulët se norma referuese e mashtrimit për të njëjtin lloj transaksioni pagese të treguar në tabelën e përcaktuar në shtojcës të kësaj rregullore:

   1.1. norma e përgjithshme e mashtrimit për çdo lloj transaksioni llogaritet si vlera totale e transaksioneve të paautorizuara ose mashtruese në distancë, pavarësisht nëse fondet janë rikuperuar apo jo, pjesëtuar me vlerën totale të të gjitha transaksioneve në distancë për të njëjtin lloj transaksionesh, pavarësisht nëse janë të autentifikuara nëpërmjet zbatimit të autentifikimit të thelluar të klientit ose të ekzekutuara në përputhje me përjashtimet e parashikuara në nenet 14 deri në 19 të kësaj rregullore në baza tremujore (90 ditë).

2. Llogaritja e normave të mashtrimit dhe shifrave që rezultojnë vlerësohen nga rishikimi i auditimit të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 2 të kësaj rregullore, i cili siguron që ato të jenë të plota dhe të sakta.

3. Metodologjia dhe çdo model i përdorur nga OSHP-ja për t'i llogaritur normat e mashtrimit, si dhe vetë normat e mashtrimit, dokumentohen në mënyrë adekuate dhe vihen plotësisht në dispozicion të BQK-së.

Neni 21
Ndërprerja e përjashtimeve bazuar në analizën e rrezikut të transaksionit

1. OSHP-të që përdorin përjashtimin e përcaktuar në nenin 18 të kësaj rregullore raportojnë menjëherë në BQK kur një nga normat e tyre të mashtrimit të monitoruara, për çdo lloj transaksioni pagese të treguar në tabelën e paraqitur në shtojcën 1 të kësaj rregullore, tejkalon normën referencë të zbatueshme të mashtrimit dhe duhet t'i ofrojë BQK-së një përshkrim të masave që ata synojnë t'i miratojnë për të rivendosur përputhshmërinë e normës të monitoruar të mashtrimit me normën e referencës së aplikuar të mashtrimit.

2. OSHP-të ndërpresin menjëherë përdorimin e përjashtimit të përcaktuar në nenin 19 të kësaj rregullore për çdo lloj transaksioni pagese të treguar në tabelën e përcaktuar në shtojcë në kufirin specifik të përjashtimit, kur shkalla e tyre e monitorimit të mashtrimit tejkalon për dy tremujorë

radhazi normën referuese të mashtrimit, të zbatueshme për atë instrument pagese ose lloj transaksioni pagese në atë interval të pragut të përjashtimit.

3. Pas përfundimit të përjashtimit të përcaktuar në nenin 19, të kësaj rregullore në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, OSHP-të nuk përdorin përsëri atë përjashtim, derisa norma e tyre e llogaritur e mashtrimit të jetë e barabartë ose më e ulët se normat referencë të mashtrimit të zbatueshme për atë lloj transaksioni pagese në atë interval të pragut të përjashtimit për një tremujor.
4. Kur OSHP-të synojnë të përdorin përsëri përjashtimin e përcaktuar në nenin 19 të kësaj rregullore, ata njoftojnë BQK-në në një afat të arsyeshëm kohor dhe para se të përdorin përsëri përjashtimin, duhet të ofrojnë dëshmi të rivendosjes së përputhshmërisë së normës së tyre të mashtrimit të monitoruar me normën referencë të mashtrimit, të zbatueshme sipas intervaleve përkatëse të përjashtimit, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 22
Monitorimi

1. Për të shfrytëzuar përjashtimet e përcaktuara në nenet 11 deri në 19 të kësaj rregullore, OSHP-të regjistrojnë dhe monitorojnë të dhënat e mëposhtme për çdo lloj transaksioni pagese, me një ndarje për transaksionet e pagesave në distancë dhe jo në distancë, të paktën në baza tremujore:
   1.1. vlerën totale të transaksioneve të pagesave të paautorizuara ose me qëllim mashtrimi në përputhje me nenin 64 paragrafin 2 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, vlerën totale të të gjitha transaksioneve të pagesave dhe normën e mashtrimit që rezulton, duke përfshirë një ndarje të transaksioneve të pagesave të nisura përmes autentifikimit të thelluar të klientit dhe sipas secilit prej përjashtimet;
   1.2. vlerën mesatare të transaksionit, duke përfshirë një ndarje të transaksioneve të pagesave të nisura përmes autentifikimit të thelluar të klientit dhe sipas secilit prej përjashtimeve;
   1.3. numrin e transaksioneve të pagesave ku është zbatuar secili prej përjashtimeve dhe përqindjen e tyre në lidhje me numrin total të transaksioneve të pagesave.
2. OSHP-të do t'i vënë në dispozicion të BQK rezultatet e monitorimit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

KAPITULLI IV
KONFIDENCIALITETI DHE INTEGRITETI I KREDENCIALEVE TË PERSONALIZUARA TË SIGURISË TË PËRDORUESVE TË SHËRBIMIT TË PAGESËS

Neni 23
Kërkesat e përgjithshme

1. OSHP-të duhet të sigurojnë konfidencialitetin dhe integritetin e kredencialeve të personalizuara të sigurisë të PSHP, duke përfshirë kodet e autentifikimit, gjatë të gjitha fazave të autentifikimit.
2. Për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni, OSHP-të duhet të sigurojnë që secila nga kërkesat e mëposhtme është përmbushur:

2.1. Kredencialet e personalizuara të sigurisë shfaqen të maskuara dhe nuk janë të lexueshme në masën e tyre të plotë kur futen nga PSHP gjatë autentifikimit;

2.2. kredencialet e personalizuara të sigurisë në formatin e të dhënave, si dhe materialet kriptografike që lidhen me enkriptimin e kredencialeve të personalizuara të sigurisë nuk ruhen në tekst të thjeshtë;

2.3. materiali sekret kriptografik mbrohet nga zbulimi i paautorizuar.

